



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Oda e infermierëve, mamive dhe profesionistëve tjerë shëndetësor të Kosovës
Komora medicinskoh sestara, babica i ostalih zdravstvenih stručnjaka Kosova
The Kosovo Chamber of nurses, midwives and other health professionals

REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO			
Oda e infermierëve, mamive dhe profesionistëve tjerë shëndetësor të Kosovës Komora medicinskoh sestara, babica i ostalih zdravstvenih stručnjaka Kosova Chamber of nurses, midwives and other health professionals of Kosovo			
ARKIV / ARCHIV / ARCHIVE			
Nr. Prot Broj. prot Prot. no	Nr. i fag. Er. str. No. page		Data: Datum: Date:
153	8		02.03.2026
PRISHTINE - PRISTINA - PRISTINA			

KUVENDI I ODËS SË INFERMIERËVE, MAMIVE DHE PROFESIONISTËVE TJERË SHËNDETËSOR TË KOSOVËS (OIK), në mbështetje të nenit 19, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 të Ligjit për Odat e Profesionistëve Shëndetësorë nr. 04/L-150, nenit 17, paragrafi 4, nenit 18, paragrafi 2 të Statutit të OIK dhe nenit 58 të Rregullores për zgjedhjen dhe shkarkimin e anëtarëve të organeve të OIK, në mbledhjen e mbajtur më 27.02.2026, miraton këtë:

RREGULLORE ZGJEDHORE

VOTIMI, NUMËRIMI NË VENDVOTIM DHE MENAXHIMI I VENDVOTIMIT

Neni 1

Qëllimi

Kjo Rregullore përcakton procesin e votimit, numërimit brenda Vendvotimit (VV), menaxhimin e Vendvotimit, rolin e vëzhguesve, librin e votimit, materialet për informim të votuesve, procedurat para fillimit të votimit, të drejtën e votës, dokumentet e pranueshme për votim, votimin e rregullt, procesin e numërimit të rezultateve në Vendvotim dhe procedurat e pranimit dhe dorëzimit të materialit zgjedhor në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ).

Neni 2

Përkufizimet dhe shkurtesat

Për qëllimet e kësaj Rregulloreje, termat dhe shkurtesat e mëposhtme kanë këtë kuptim:

1. **OIK** – Oda e Infermierëve, Mamive dhe Profesionistëve të tjerë Shëndetësorë të Kosovës;
2. **KQZ** – Komisioni Qendror i Zgjedhjeve;
3. **SKQZ** – Sekretariati i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve;
4. **KNJZ** – Komisioni i Njësisë Zgjedhore;
5. **VV** – Vendvotimi;
6. **LV** – Lista Votuese;
7. **FPR** – Formulari i Përputhjes së Rezultateve;
8. **FRK** – Formulari i Rezultateve të Kandidatëve.

Neni 3

Vendvotimi dhe vendndodhja

1. Adresa e Vendvotimit miratohet nga KQZ, sipas detyrës zyrtare ose me propozim të Komisionit të Njesisë Zgjedhore (KNJZ).
2. Vendvotimet vendosen në një vend të përshtatshëm për hyrje dhe dalje, me qëllim që t'u mundësohet votuesve krijimi i rreshtit.
3. Vendvotimi duhet të jetë mjaftueshëm i madh për të siguruar zhvillimin e rregullt të votimit, duke vendosur të gjitha tavolinat e punës sipas kësaj Rregulloreje dhe duke garantuar fshehtësinë e votimit, shikimin dhe kontrollin e lirë të kutisë së votimit, si dhe qasje të papenguar për vëzhguesit.

Neni 4

Përbërja dhe menaxhimi i Vendvotimit

1. Vendvotimi menaxhohet nga Kryesuesi i Komisionit të Njesisë Zgjedhore, i cili obligohet të sigurojë që në Vendvotim të jenë të pranishëm:
 - 1.1. anëtarët e KNJZ-së;
 - 1.2. vëzhguesit e akredituar, por jo më shumë se një vëzhgues për kandidat;
 - 1.3. votuesit me të drejtë vote në atë Vendvotim, gjatë ushtrimit të së drejtës së votës.
2. Kryesuesi, së bashku me anëtarët e KNJZ-së, sigurohet që të bëhen të gjitha përgatitjet paraprake për fillimin e procesit të votimit.
3. Kryesuesi i KNJZ-së është përgjegjës për të gjitha aktivitetet në Vendvotim, nga procesi i pranimit të materialit zgjedhor e deri në dorëzimin e tij në KQZ.
4. Përfshihet nga paragrafi 1 i këtij neni, përkohësisht mund të jenë të pranishëm edhe:
 - 4.1. stafi i KQZ-së;
 - 4.2. vëzhguesit e akredituar të organizatave, kandidatëve dhe mediave.

Neni 5

Materiali i informimit të votuesve dhe shenjat orientuese në Vendvotim

1. KQZ sigurohet për përgatitjen e materialeve për informim të votuesve në Vendvotim.
2. Kryesuesi i KNJZ-së obligohet që këto materiale t'i vendosë një ditë para ditës së zgjedhjeve në hapësirat e Vendvotimit, nëse është e mundur, por jo më larg se para fillimit të orarit zyrtar të votimit.
3. KQZ sigurohet për përgatitjen e shenjave orientuese për informimin e votuesve në Vendvotim, të cilat duhet të jenë të dukshme. Kryesuesi i Vendvotimit obligohet që të njëjtat t'i vendosë në hapësirat e dukshme të Vendvotimit.
4. Shenjat orientuese për informim të votuesve në Vendvotim përfshijnë, por nuk kufizohen në:
 - 4.1. emrin dhe kodin e Njesisë Zgjedhore;
 - 4.2. shenjat për orientimin e votuesve drejt Vendvotimit;
 - 4.3. posterin me listën e ndalesave, që përfshin ndalimin e mbajtjes së armëve, fotografimin e votës, votimin grupor dhe ndalesa të tjera të përcaktuara nga KQZ.

Neni 6

Libri i votimit

1. Çdo Vendvotim ka librin e votimit, në të cilin shënohen të gjitha ngjarjet që lidhen me mbarëvajtjen e procesit të votimit dhe numërimin në Vendvotim gjatë ditës së zgjedhjeve, duke përfshirë edhe të dhënat statistikore të pjesëmarrjes së votuesve në zgjedhje, sipas intervaleve kohore të përcaktuara nga KQZ.
2. Vetëm Kryesuesi i KNJZ-së, anëtarët e KNJZ-së dhe vëzhguesit e akredituar të pranishëm lejohen të bëjnë shënime në librin e votimit.
3. Nëse votuesi ka ankesë lidhur me ndonjë aktivitet brenda Vendvotimit, ai ose ajo mund të kërkojë nga Kryesuesi i KNJZ-së regjistrimin e ankesës në librin e votimit dhe udhëzohet për të marrë formularin e ankesës në tryezën ndihmëse të Vendvotimit.

Neni 7

Mbarëvajtja në Vendvotim

1. Kryesuesi i Komisionit të Njësisë Zgjedhore (KNJZ), me ndihmën e të gjithë anëtarëve, duhet të sigurojë mbarëvajtjen e procesit të votimit brenda Vendvotimit (VV).
2. Në rast të pengimit të procesit zgjedhor, Kryesuesi mund të udhëzojë një anëtar të KNJZ-së, vëzhgues apo votues që të lirojë hapësirën e Vendvotimit. Për largimin e një anëtari të KNJZ-së kërkohet aprovimi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ). Për largimet e tjera, KQZ njoftohet brenda dy (2) orëve nga rasti, ndërsa KQZ merr vendimin përfundimtar.
3. Në rast se cenohet siguria dhe mbarëvajtja e procesit zgjedhor brenda Vendvotimit, Kryesuesi i KNJZ-së kërkon ndihmë të menjëhershme nga policia, njofton KQZ-në dhe mund të vendosë pezullimin e përkohshëm të procesit të votimit në Vendvotim deri në rivendosjen e rendit. Gjatë kohës së pezullimit, në Vendvotim qëndrojnë vetëm anëtarët e KNJZ-së dhe vëzhguesit. Kryesuesi dhe anëtarët kujdesen për materialet e ndjeshme zgjedhore, ndërsa Kryesuesi e shënon ngjarjen në librin e votimit, duke përfshirë edhe kohëzgjatjen e pezullimit të votimit.
4. Asnjë informatë e fushatës zgjedhore të kandidatëve nuk lejohet të transmetohet nga asnjë pajisje komunikimi në Vendvotim dhe as në distancë të dëgjueshme brenda hapësirave të Vendvotimit. Një veprim i tillë raportohet nga KNJZ-ja në KQZ menjëherë pas evidentimit të shkeljes.

Neni 8

Përgatitja teknike e Vendvotimit para ditës së zgjedhjeve

1. Përgatitja teknike dhe rregullimi i Vendvotimit bëhen jo më vonë se një (1) orë para fillimit të orarit zyrtar të votimit.
2. KNJZ pranon dhe verifikon materialin zgjedhor dhe rregullon hapësirën brenda Vendvotimit.
 - 2.1. Mënyra e organizimit të Vendvotimit duhet të mundësojë qarkullim të lirë të votuesve dhe të ofrojë transparencë;
 - 2.2. Ulëset dhe tavolinat rregullohen në atë mënyrë që anëtarët e KNJZ-së dhe vëzhguesit e zgjedhjeve të mund të shohin tërë procesin e votimit dhe t'i shohin qartë kutitë e votimit gjatë gjithë kohës;
 - 2.3. Kabinat e votimit vendosen në kënd të hapësirës, në atë mënyrë që të sigurohet fshehtësia e votimit për secilin votues.

Neni 9

Aktivitetet e KNJZ-së para fillimit të votimit

1. Në rast se, gjatë kohës së përcaktuar për pranim-dorëzimin e materialit zgjedhor të ndjeshëm, nuk është prezent Kryesuesi i KNJZ-së, KQZ ndërmerr veprime të menjëhershme për të kontaktuar Kryesuesin ose për ta zëvendësuar atë sipas procedurave të përcaktuara.
2. Kryesuesi sigurohet që materiali jo i ndjeshëm, materiali informues dhe orientues të jetë i vendosur në mënyrë të duhur dhe të dukshme në Vendvotim.
3. Kryesuesi konstaton prezencën e anëtarëve të KNJZ-së dhe të vëzhguesve, dhe të njëjtën e evidenton në librin e votimit. Kryesuesi i KNJZ-së e informon KQZ-në për çdo anëtar të KNJZ-së që mungon dhe kërkon zëvendësim.
4. Në rast se vëzhguesit nuk janë pajisur paraprakisht me kartela identifikuese (ID) nga KQZ, Kryesuesi i KNJZ-së i pajis vëzhguesit me kartela identifikuese.

Neni 10

Orari i votimit

1. Vendvotimet hapen në orën 07:00 dhe mbyllen në orën 19:00.
2. Kryesuesi i Vendvotimit shënon kohën e hapjes dhe mbylljes së Vendvotimit në librin e votimit.
3. Nëse Vendvotimi hapet me vonesë, Kryesuesi i KNJZ-së e njofton menjëherë KQZ-në dhe shënon arsyen e vonesës në librin e votimit.
4. Askush nuk mund të votojë pas kohës së mbylljes së Vendvotimit, përveç votuesve që ndodhen në radhë para Vendvotimit në momentin e mbylljes.

Neni 11

E drejta e votës dhe fshehtësia e votës

1. Votuesi e ushtron të drejtën e tij për të votuar pa u penguar nga askush.
2. Anëtarët e KNJZ-së ushtrojnë të parët të drejtën e votës.
3. Asnjë person nuk lejohet të votojë në emër të një personi tjetër apo më shumë se një herë në të njëjtat zgjedhje.
4. Votuesi e plotëson fletëvotimin në fshehtësi, në kabinën e votimit, dhe vetëm ai lejohet të qëndrojë në kabinën e votimit gjatë votimit.
5. Votuesi mund të kërkojë sqarime lidhur me procedurën e votimit nga dhënësi i fletëvotimit.
6. Anëtarëve të KNJZ-së u ndalohet në çdo mënyrë ndikimi në vendimin e votuesit.
7. Anëtarët e KNJZ-së sigurojnë që votuesi të mos shqetësohet nga askush gjatë votimit dhe që fshehtësia e votës të garantohet plotësisht.

Neni 12

Dokumentet e pranueshme të identifikimit

1. Çdo votues identifikohet nga zyrtari i identifikimit në Vendvotim përmes njërës nga dokumentet e vlefshme të identifikimit, të lëshuara nga Republika e Kosovës, si në vijim:
 - 1.1. Kartela identifikuese e OIK-ut;
 - 1.2. Letërnjoftimi;
 - 1.3. Pasaporta;
 - 1.4. Leja e vozitjes.

Neni 13

Votimi

1. Pas hyrjes në Vendvotim (VV), votuesi udhëzohet që të vazhdojë te zyrtari i identifikimit, i cili kontrollon nëse emri dhe mbiemri i votuesit figurojnë në Listën Votuese (LV):
 - 1.1. Nëse emri dhe mbiemri i votuesit figurojnë në LV pa shenjë ose shënim, votuesi udhëzohet që të nënshkruajë në LV pranë emrit të tij/saj;
 - 1.2. Nëse emri dhe mbiemri i votuesit nuk figurojnë në LV, për këtë informohet menjëherë Sekretariati i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (SKQZ) dhe rasti shënohet si vërejtje në librin e votimit;
 - 1.3. Nëse anëtar i Komisionit të Njesisë Zgjedhore (KNJZ) vëren se votuesi gabimisht është nënshkruar në hapësirën e një votuesi tjetër në LV, ai menjëherë e njofton Kryesuesin dhe e udhëzon votuesin të nënshkruajë në hapësirën e tij/saj në LV, ndërsa nënshkrimi i gabuar anulohet duke u shënuar anash LV dhe duke u regjistruar numri i rastit në librin e votimit. Rasti evidentohet në librin e votimit, duke shënuar kohën e saktë dhe të dhënat e votuesit;
 - 1.4. Votuesi, në hapësirën e të cilit është evidentuar gabimi i nënshkrimit paraprak, njoftohet për rastin dhe udhëzohet që të nënshkruajë në hapësirën e tij/saj në LV;
 - 1.5. Pas nënshkrimit në LV, votuesi udhëzohet që të vazhdojë te dhënësi i fletëvotimit;
 - 1.6. Votuesit i cili refuzon të nënshkruhet në LV nuk i jepet fletëvotimi, ndërsa Kryesuesi i Vendvotimit sigurohet që i njëjti të largohet nga VV. Rasti evidentohet në librin e votimit.
2. Dhënësi i fletëvotimit, me kërkesë të votuesit, sqaron mënyrën e votimit dhe me kujdes ndan fletëvotimin nga pjesa amë në hapësirën e caktuar. Votuesit i jepet fletëvotimi dhe ai udhëzohet të shkojë në njërën nga kabinat e votimit për të votuar në fshehtësi.
3. Nëse votuesi e dëmton fletëvotimin, ai ose ajo e dorëzon fletëvotimin e dëmtuar te Kryesuesi i KNJZ-së, i cili e udhëzon te dhënësi i fletëvotimit për të marrë fletëvotim të ri. Kryesuesi e tregon fletëvotimin e dëmtuar para anëtarëve të KNJZ-së dhe vëzhguesve, shënon në pjesën e prapme të fletëvotimit të dëmtuar fjalën "I DËMTUAR" dhe e vendos atë në zarfin e posaçëm për fletëvotime të dëmtuara. Rasti evidentohet në librin e votimit, duke shënuar kohën dhe numrin serik të pjesës amë të fletëvotimit.
4. Pas votimit, votuesi obligohet që ta palosë fletëvotimin dhe ta vendosë atë në kutinë përkatëse të votimit.
5. Mbikëqyrësi i kutisë së votimit sigurohet që votuesit të vendosin vetëm fletëvotimin përkatës në kutinë e votimit.
6. Mbikëqyrësi i kutisë së votimit nuk duhet të lejojë asnjë votues të largohet nga Vendvotimi pa e vendosur fletëvotimin në kutinë përkatëse të votimit. Refuzimi i votuesit për të vepruar në përputhje me këtë kërkesë raportohet menjëherë te

Sekretariati i KQZ-së dhe evidentohet në librin e votimit, duke shënuar kohën dhe të dhënat personale të personit.

Neni 14

Mbyllja e Vendvotimit

1. Vendvotimet mbyllen në orarin e përcaktuar me këtë Rregullore. Çdo person që ndodhet në radhë brenda Vendvotimit në momentin e mbylljes lejohet të votojë. Kryesuesi i KNJZ-së sigurohet që të gjithë votuesit që ndodhen në radhë brenda Vendvotimit të votojnë. Personi që vjen pas mbylljes së Vendvotimit nuk lejohet të votojë.
2. Përgjashtimisht nga paragrafi 1 i këtij neni, KQZ-ja, në rast të shfaqjes së forcës madhore, mund të vendosë për zgjatjen e orarit të votimit për një ose më shumë Vendvotime, pas njoftimit nga KNJZ-ja.
3. Pas votimit të personit të fundit në radhë, Kryesuesi i KNJZ-së e mbyll Vendvotimin, mbyll kapakun e kutisë së votimit me shirit sigurie në mënyrë që kjo të jetë e dukshme për vëzhguesit, ndërsa në librin e votimit shënon kohën e saktë të mbylljes dhe numrin e shiritit të sigurisë, i cili shënohet edhe në Formularin e Përputhjes së Rezultateve (FPR).

Neni 15

Procesi i numërimit në Vendvotim

1. Procedurat e numërimit të fletëvotimeve udhëhiqen nga këto parime:
 - 1.1. saktësia;
 - 1.2. transparencë;
 - 1.3. efikasiteti;
 - 1.4. integriteti;
 - 1.5. mbrojtja e sigurisë së votës.
2. Pas mbylljes së Vendvotimit, Kryesuesi i KNJZ-së shënon në librin e votimit emrat, numrat personalë dhe numrat e akreditimit të të gjithë vëzhguesve të pranishëm dhe i informon ata se, nëse largohen nga Vendvotimi para përfundimit të numërimit, nuk lejohen të kthehen në Vendvotim.
3. Gjatë procesit të numërimit, Kryesuesi i KNJZ-së nuk lejon asnjë person të hyjë në Vendvotim, përveç anëtarëve të KNJZ-së, përfaqësuesve të KQZ-së dhe zyrtarëve të autorizuar nga KQZ. Personat e tillë evidentohen në librin e votimit.
4. Para fillimit të numërimit, Kryesuesi i KNJZ-së i udhëzon anëtarët që të:
 - 4.1. largojnë lapsat dhe materialet e tjera të përdorura gjatë procesit të votimit që nuk nevojiten për numërim;
 - 4.2. organizojnë hapësirën e numërimit në mënyrë që të mundësohet numërimi efikas për anëtarët e KNJZ-së dhe transparencë për vëzhguesit;
 - 4.3. shpërndajnë lapsat dhe materialet administrative të dedikuara për numërim, përfshirë Formularin e Rezultateve, fletë-shënime dhe materialet e tjera të përcaktuara sipas procedurës.
5. Kryesuesi i KNJZ-së ndan detyrat për anëtarët e KNJZ-së si në vijim:
 - 5.1. Dhënësi i fletëvotimit, i ndihmuar nga një anëtar i KNJZ-së, llogarit numrin e nënshkrimeve në Listën Votuese (LV), ndërsa Kryesuesi e shënon këtë numër në formular. Gjatë këtij procesi nuk lejohet zhvillimi i asnjë veprimi tjetër paralel;
 - 5.2. Zyrtari i identifikimit, i ndihmuar nga një anëtar i KNJZ-së, evidenton dhe numëron:
 - 5.2.1. fletëvotimet e papërdorura;

5.2.2. fletëvotimet e dëmtuara, të cilat vendosen në zarfin e posaçëm për fletëvotime të dëmtuara;

5.3. Kryesuesi i KNJZ-së sigurohet që rezultatet e pranuar sipas nënparagrafit 5.2 të këtij neni të shënohen saktë në formular.

6. Para hapjes së kutisë së votimit, Kryesuesi i KNJZ-së verifikon numrat e shiritave mbyllës të kutisë së votimit dhe kontrollon nëse këta numra përputhen me numrat e regjistruar në formular, si dhe ndan veçmas fletëvotimet e papërdorura, zarfet me fletëvotime të dëmtuara dhe Listën Votuese.
7. Gjatë hapjes së kutisë së votimit, Kryesuesi i KNJZ-së cakton njërin nga anëtarët e KNJZ-së për të hequr shiritat mbyllës dhe për të hapur kutinë e votimit. Shiritat vendosen në thesin përkatës, i cili në fund të procesit mbyllet me shirit sigurie.
8. Kryesuesi cakton një anëtar për të hapur kutinë e votimit dhe për të nxjerrë fletëvotimet, duke u siguruar që asnjë fletëvotim të mos mbetet brenda kutisë së votimit.
9. Kryesuesi dhe anëtarët e KNJZ-së numërojnë dhe klasifikojnë të gjitha fletëvotimet sipas kësaj renditjeje:
 - 9.1. shpalosin fletëvotimet duke i kthyer mbrapsht;
 - 9.2. i kthejnë fletëvotimet mbarë dhe i klasifikojnë në fletëvotime të vlefshme dhe të pavlefshme;
 - 9.3. ndajnë fletëvotimet e vlefshme sipas kandidatëve;
 - 9.4. pas ndarjes së fletëvotimeve, numërohen votat për secilin kandidat veç e veç dhe ndahen në dengje prej nga pesëdhjetë (50) fletëvotimesh;
 - 9.5. fletëvotimet rinumërohen për të verifikuar nëse ekziston ndonjë mospërputhje ndërmjet numrit të fletëvotimeve në kuti dhe numrit të nënshkrimeve në Listën Votuese;
 - 9.6. nëse edhe pas rinumërimit konstatohet mospërputhje, kutia e votimit mbyllet, sinjalizohet dhe përcillet në KQZ.

Neni 16

Vlefshmëria e fletëvotimit dhe votës

1. Vota është e vlefshme kur është votuar vetëm një kandidat dhe kur qëllimi i votuesit është i qartë.
2. Vota konsiderohet e pavlefshme në rastet kur:
 - 2.1. votohet më shumë se një kandidat;
 - 2.2. nuk votohet asnjë kandidat;
 - 2.3. qëllimi i votuesit nuk është i qartë, sipas procedurave të votimit dhe numërimit në Vendvotim.
3. Nëse anëtarët e KNJZ-së nuk arrijnë marrëveshje lidhur me vlefshmërinë e votës, Kryesuesi i KNJZ-së merr vendimin përfundimtar për atë votë dhe rasti evidentohet në librin e votimit.
4. Anëtarët e tjerë të KNJZ-së dhe vëzhguesit e pranishëm në Vendvotim kanë të drejtë të mbajnë shënime gjatë numërimit dhe, në rast të gabimeve, të tërheqin vërejtjen.

Neni 17

Paraqitja e rezultateve në formularë

1. Votat e numëruara për kandidatët shënohen nga Kryesuesi i KNJZ-së në Formularin e Rezultateve të Kandidatëve (FRK).
2. Pas përfundimit të numërimit, evidentimit të të gjitha fletëvotimeve dhe plotësimit të formularëve përkatës, paketimi i materialeve zgjedhore dhe mbyllja e kutive bëhen sipas procedurave të miratuara nga KQZ.

3. Anëtarët e KNJZ-së janë përgjegjës për saktësinë e rezultateve dhe për plotësimin korrekt të shënimeve në formularët përkatës.

Neni 18

Procedurat pas pranimit të materialit

Pranimi i materialit zgjedhor në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) bëhet nga Sekretariati i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (SKQZ), i cili për këtë qëllim pajis Komisionin e Njësisë Zgjedhore (KNJZ) me një kopje të procesverbalit të pranimit të materialit zgjedhor.

Neni 19

Kundërshtimi

1. Ankesat lidhur me procesin e votimit dhe numërimit në Vendvotim (VV) dorëzohen në KQZ brenda njëzet e katër (24) orëve nga mbyllja e Vendvotimit.
2. KQZ vendos mbi kundërshtimin brenda dyzet e tetë (48) orëve nga pranimi i ankesës.
3. Pala e pakënaqur me vendimin e KQZ-së ka të drejtë ankese në Gjykatën e Nderit brenda njëzet e katër (24) orëve nga pranimi i vendimit.
4. KQZ-ja certifikon rezultatin zgjedhor jo më larg se pesë (5) ditë nga dita e mbajtjes së zgjedhjeve, në përputhje me përcaktimet e Rregullores për zgjedhjen dhe shkarkimin e anëtarëve të organeve të Odës së Infermierëve, Mamive dhe Profesionistëve të tjerë Shëndetësorë të Kosovës (OIK).

Neni 20

Dispozitat përfundimtare

KQZ vendos për të gjitha çështjet që nuk janë të përcaktuara në mënyrë taksative me këtë Rregullore, në përputhje me legjislacionin në fuqi, Statutin e OIK-ut dhe rregulloret përkatëse zgjedhore.

Neni 21

Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi në ditën e miratimit të saj.

Prishtinë, 27.02.2026



Kryetare e OIK
Nexhmije Gori